

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 18.04.2022, në pajtim me nenin 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për Kërkesën për miratimin e qëndrimit parimor, të parashtruar nga avokati Nigjail Z. Merxhanoski nga Struga, nxori këtë:

## **K O N K L U Z I O N**

Iniciativa e parashtruar nga avokati Nigjail Z. Merxhanoski nga Struga, e evidentuar nën 03Su.nr.961/21 të datës 30.12.2021, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor mbi çështjen juridike për të drejtën e garantuar dyshkallëshe të procedurës në kushte kur është parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës kontestuese në gjykatën e shkallës së dytë me përmbajtjen si vijon: “Kur parashtrimi i propozimit për përsëritjen e procedurës kryesisht ka të bëjë me përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit, nëse kjo gjykatë me vendim të plotfuqishëm të saj e ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë që është bërë i plotfuqishëm, në atë rast përsëritja e procedurës mund të kërkohet kryesisht në gjykatën e apelit. Gjykata e Apelit me propozim për përsëritjen e procedurës miraton vendim në të cilin palët kanë të drejtë të ankesës në Gjykatën Supreme të RMV, që vendos në shkallën e dytë, për ankesat e parashtruara të palëve”, NUK MIRATOHET.

## **A r s y e t i m**

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.58/06/ ... nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 18.04.2022 shqyrtoi mbi Inicativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor 03Su.nr.961/21 të datës 30.12.2021, të parashtruar nga Nigjail Z. Merxhanoski, avokat nga Struga, lidhur me çështjen e garantuar dyshkallëshe të procedurës në kushte kur është parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës kontestuese në gjykatën e shkallës së dytë.

Në iniciativën është shtruar situatë juridike respektivisht dilemë që ka të bëjë me të drejtën e garantuar dyshkallëshe të procedurës në kushte kur është parashtruar propozim për përsëritjen e procedurës kontestuese në gjykatën e shkallës së dytë.

Në kërkesën është theksuar se ekziston një boshllëk juridik – papërcaktueshmëri në nenin 399 paragrafi të Ligjit për procedurë kontestuese në pjesën “Kur shkaku për

përsëritjen e procedurës ka të bëjë kryesisht për procedurën para gjykatës më të lartë”, dhe në lidhje me të drejtën e garantuar dyshkallëshe të procedurës, dhe nevojitet që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të prononcohet dhe të miratojë qëndrim parimor për procedimin e drejtë dhe vendimmarrjen deri sa një boshllëk i tillë juridik të plotësohet me intervenimin e vet Ligjit për procedurë kontestimore. Tërë kjo, në bazë të nenit 2, nenit 3, nenit 5 paragrafi (1), nenit 8, nenit 18 paragrafi (4), nenit 19 paragrafi (2), nenit 35, nenit 36 paragrafi (1) pika 6 dhe nenit 37 të Ligjit për gjykatat. Ashtu, për shkak të respektimit të denjë të parimit dyshkallësh të procedurës së garantuar me Kushtetutë, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, si dhe Ligjin për gjykatat, parashtuesi konsideron se Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me zbatimin direkt të dispozitave nga amendamenti XXI me të cilin është zëvendësuar neni 15 nga Kushtetuta ose nenit 13 nga KEDNJ duhet të miratojë qëndrim parimor, sipas të cilit qytetarët do të mund të realizojnë këtë të drejtë të patjetërsueshme, dhe parashtuesi propozon që i njëjti të jetë me përmbajtjen si vijon: “Kur parashtimi i propozimit për përsëritjen e procedurës kryesisht ka të bëjë me përsëritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit, nëse kjo gjykatë me vendim të plotfuqishëm të saj e ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë që është bërë i plotfuqishëm, në atë rast përsëritja e procedurës mund të kërkohet kryesisht në gjykatën e apelit. Gjykata e Apelit me propozim për përsëritjen e procedurës miraton vendim në të cilin palët kanë të drejtë të ankesës në Gjykatën Supreme të RMV, që vendos në shkallën e dytë, për ankesat e parashtuara të palëve”,

Kërkesën e këtillë, parashtuesi e arsyeton me aktvendime të bashkëngjitura të Gjykatës Themelore Ohër dhe Gjykatës së Apelit Manastir, nga të cilat sipas tij rezulton se këshillat gjyqësor të Gjykatës së Apelit Manastir vendosin “ndryshëm”, përkatësisht disa këshilla vendosin në shkallën e dytë pa këshillë juridike për të drejtë të ankesës në gjykatën më të lartë (“Gjykatën Supreme”), ngase me Ligjin për procedurë kontestimore nuk është përcaktuar, përderisa disa këshilla gjyqësor vendosin në shkallën e dytë me improvizim dyshkallësh me të drejtë të ankesës në mënyrë që me letër e kthejnë lëndën mbrapa në gjykatën e shkallës së parë me kërkesë, që ajo të veprojë dhe të vendos në shkallën e parë. Në këtë mënyrë, në rastin e dytë, gjykata e shkallës së parë vepron dhe vendos me aktvendim me këshillë për të drejtë të ankesës në gjykatën e apelit (si gjykatë e shkallës së dytë) që vepron për ankesën. Në vazhdim, tregon se gjatë situatës së zbatimit të nenit 399 të Ligjit për procedurë kontestimore, gjykata e apelit vepron dhe vendos në shkallën e parë dhe konsideron se me miratimin e qëndrimit parimor duhet të sigurohet realizimi i të drejtës së ankesës reale në mënyrë që do të mundësohet që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të vendos për ankesën e deklaruar kundër aktvendimit të miratuar në procedurën për përsëritjen kur shkakun qëndron kryesisht në gjykatën më të lartë. Njëkohësisht, parashtuesi thekson se nuk din se si është qëndrimi për këtë çështje në gjykatat tjera të apelit.

Përsëritja e procedurës, nga aspekti i procedurës civile si institut juridik është rregulluar me dispozitat nga Pjesa e 2 nga Kreu i XXV të Ligjit për procedurë kontestimore (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.79/05, 110/08, 83/09, 116/10 dhe 124/15).

Në këtë mënyrë, sipas nenit 399 paragrafi (1) nga ky Ligj kur shkak për përsëritjen e procedurës ka të bëjë kryesisht për procedurën para gjyqit më të lartë, gjykatësi individ respektivisht kryetari i këshillit të gjyqit të shkallës së parë pas mbajtjes së seancës për diskutim për propozimin e përsëritjes së procedurës do ta paraqesë lëndën në atë gjykatë më të lartë për shkak të marrjes së vendimit.

Njëkohësisht, me nenin 391 nga i njëjti Ligj është paraparë se palët mund të deklarojnë revizion edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin procedura plotfuqishëm ka përfunduar në kontestet, në të cilat revizioni do të ishte i lejueshëm kundër aktgjykimit të shkallës së dytë.

Me nenin 15 nga Kushtetuta, garantohet e drejta e ankesës kundër akteve të veçanta juridike, të miratuara në procedurën e shkallës së parë para gjykatës, organit administrativ apo organizatës ose institucioneve të tjera që kryejnë autorizime publike.

Sipas nenit 35 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/2006, 35/2008, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 96/19), Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë është kompetente: 1) të vendosë në shkallë të dytë kundër vendimeve të këshillave të vet kur ajo është përcaktuar me ligj; 2) të vendosë në shkallë të tretë dhe të fundit ndaj ankesave kundër vendimeve të gjykatave të apelit; 3) të vendosë në shkallë të dytë ndaj ankesës së vendimit të Gjykatës Administrative në rastet e përcaktuara me ligj; 4) të vendos ndaj mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjyqeve dhe vendimeve të këshillave të tyre kur ajo është përcaktuar me ligj; 5) të vendos për ndeshje të kompetencave midis gjykatave themelore nga rajoni i gjykatave të ndryshme të apelit, ndeshje të kompetencave midis Gjykatës Administrative dhe një gjykate tjetër, ndeshje të kompetencave ndërmjet Gjykatës së Lartë Administrative dhe një gjykate tjetër dhe të vendosë për bartjen e kompetencës vendore te këto gjykata; 6) të vendosë ndaj kërkesave të palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën për cenimin e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm, në procedurë të përcaktuar me ligj para gjykatave në Republikën e Maqedonisë në pajtim me rregullat dhe principet e miratuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe 7) të kryejë punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Gjatë kontrollimit të praktikës gjyqësore është konstatuar se për një situatë të tillë juridike është prononcuar edhe Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që me aktvendimin Rev2.nr. 345/2014 të datës 01.04.2015 e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e paditësve të deklaruar kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së

dytë, me të cilën është refuzuar si i pabazë propozimi për përsëritjen e procedurës para gjykatës së shkallës së dytë. Kjo, me arsyetim se ankesa paraqet mjet të rregullt juridik, që deklarohet kundër vendimeve të pa plotfuqishme, aktgjykimeve dhe aktvendimeve, të miratuara në shkallën e parë, ku e njëjta mund të deklarohet vetëm nëse për atë janë plotësuar supozimet e caktuara, nga të cilat varet lejueshmëria e mjetit juridik, ndër të cilët është edhe supozimi që ligji të kish parashikuar mundësi kundër vendimit të caktuar që të deklarohet me ligj mjeti i paraparë juridik. Më tej, është theksuar se nëse merret parasysh fakti që në rastin konkret nuk bëhet fjalë për vendim që e ka sjell gjykata që ka vendosur në shkallën e parë në kuptim të nenit 30 paragrafi (2) dhe nenit 31 paragrafi (2) të Ligjit për gjykatat, por as edhe se bëhet fjalë për vendim të këshillit të Gjykatës së Apelit Shkup, miratuar në shkallën e parë për të cilën Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ishte kompetente të vendos në shkallën e dytë, rezulton se nuk ekziston bazë ligjore që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të veprojë për ankesën në fjalë.

Duke u nisur nga dispozitat e cituara, dhe si Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vendimin e sipër miratuar ka shprehur qëndrim në lidhje me çështjen dyshkallëshe të procedurës gjatë situatës për përsëritjen e procedurës para gjykatës së shkallës së dytë, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konstaton se nuk rezulton nevoja për miratim të qëndrimit parimor.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 18.04.2022, sipas nenit 37 paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur për Kërkesën për miratimin e qëndrimit parimor, të parashtruar nga Avokatja Kristina Bačovska nga Shoqëria e Avokatëve Bačovski Sinkopi Avokatë, nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Iniciativa e parashtruar nga Avokatja Kristina Bačovska nga Shoqëria e Avokatëve Bačovski Sinkopi Avokatë, të evidentuar nën 03 Su. Nr.156/22 të datës 28.02.2022, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor për çështjen juridike: (1) Nëse gjatë zbatimit të institutit masë kohore, për propozime sipas Ligjit për konteste administrative neni 29 paragrafët (1), (2), (3), që nuk kanë të bëjnë me anulimin e zbatimit të aktit administrativ nga neni 29 paragrafët (5), (6) dhe (7) të Ligjit për konteste administrative, në mënyrë supsidiare zbatohet Ligji për procedurën kontestimore, dhe me atë edhe Ligji për sigurimin e kërkesave. (2) A lejohet propozimi për caktimin e masës së (për) kohshme sipas dispozitave nga neni 29 paragrafët (1), (2), (3), të Ligjit për konteste administrative në lidhje me nenin 31 të Ligjit për sigurimin e kërkesave para ngritjes së procedurës gjyqësore ose administrative, ose domosdo të ekzistojë procedurë gjyqësore që të mund të miratohet masë e (për) kohshme në kontest administrativ, NUK APROVOHET.

## A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat, nga Avokatja Kristina Bačovska nga Shoqëria e Avokatëve Bačovski Sinkopi Avokatë, më 28.02.2022 në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është parashtruar Iniciativë, e evidentuar nën 03 Su. Nr.156/22 të datës 28.02.2022, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor për çështjen juridike: (1) Nëse gjatë zbatimit të institutit masë kohore, për propozime sipas Ligjit për konteste administrative neni 29 paragrafët (1), (2), (3), që nuk kanë të bëjnë me anulimin e zbatimit të aktit administrativ nga neni 29 paragrafët (5), (6) dhe (7) të Ligjit për konteste administrative, në mënyrë supsidiare zbatohet Ligji për procedurën kontestimore, dhe me atë edhe Ligji për sigurimin e kërkesave. (2) A lejohet propozimi për caktimin e masës së (për) kohshme sipas dispozitave nga neni 29 paragrafët (1), (2), (3), të Ligjit për konteste administrative

në lidhje me nenin 31 të Ligjit për sigurimin e kërkesave para ngritjes së procedurës gjyqësore ose administrative, ose domosdo të ekzistojë procedurë gjyqësore që të mund të miratohet masë e (për) kohshme në kontest administrativ.

Në Iniciativën është ngritur situatë juridike respektivisht dilemë që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për konteste administrative dhe Ligjit për procedurë kontestuese respektivisht Ligjit për sigurimin e kërkesave, lidhur me institutin masë kohore respektivisht të përkohshme.

Parashtruesja e Kërkesës thekson se gjatë zbatimit të institutit masë të (për) kohshme, gjykatat civile e zbatojnë Ligjin për sigurimin e kërkesave, në mënyrë që në procedurë civile ky institut shfrytëzohet si mjet për sigurimin e kërkesave para parashtrimit të padisë civile, përderisa nga ana e Gjykatës Administrative gjatë vendimmarrjes për masë kohore absolutisht nuk zbatohet Ligji për sigurimin e kërkesave, duke shprehur qëndrim se masë kohore nuk lejohet kur nuk është parashtruar padi me të cilën ngritet kontest administrativ, duke u thërritur në nenin 29 të LKA, në mënyrë që duke vënë në dukje një lëndë konkrete përkatësisht Aktvendim të Gjykatës Administrative U-1 756/21 të datës 20.12.2021 dhe Aktvendim të Gjykatës së Lartë Administrative të RMV, UZHVM -1 nr.20/21 të datës 29.12.2021.

Parashtruesja e kërkesës konsideron se ka mospërputhshmëri gjatë veprimit të gjykatave administrative dhe civile në zbatimin e institutit masë e (për) kohshme, duke sugjeruar qëndrim se një veprim i tillë i gjykatave administrative shkaktojnë dëm për parashtruesit e kërkesave për lëshimin e masave të përkohshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për (1) procedurë për ndryshimin e pronësisë që udhëhiqet në Agjencinë e Kadastrës, për të cilën ende nuk është miratuar vendim, a ndryshimi i pronësisë do të çon në dëm të kërkuesit, dhe (2) kur bëhet fjalë për procedurë të ngritur për denacionalizim para një organi shtetëror kompetent, ndërsa aktvendimi ende nuk është miratuar, kurse ndryshimi i pronësisë së tokës shtetërore që do të duhet të kthehet, në ndërkohë RMV mund ta tjetërson në procedurën e privatizimit ose tjetërsimin sipas Ligjit për tokë ndërtimore dhe të ngjashme.

Në vazhdim të Kërkesës, parashtruesja e citon nenin 29 të LKA, në të cilin thërriten Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative, sipas të cilave, që të lëshohet masë kohore nevojitet që paraprakisht të ketë të parashtruar padi para gjykatës, në kundërshtim me nenin 31 të Ligjit për sigurimin e kërkesave, në të cilin theksohet se masa e përkohshme mund të lejohet para dhe gjatë mbajtjes së procedurës.

Parashtruesja e kërkesës konsideron se Ligji për kontest administrativ nuk e përjashton zbatimin e Ligjit për sigurimin e kërkesave, në mënyrë që konsideron se për masat e (për) kohshme në përgjithësi të rregulluara me nenin 29 paragrafi (1), (2) dhe (3) të LKA, në mënyrë supsiare duhet të zbatohet LPP përkatësisht LSK, duke bërë krahasim midis masës së (për) kohshme për zbatimin e një akti kontestues, të parashtruar sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi (5), (6), dhe (7) të LKA, si një lloj i veçantë i masës kohore për të cilën konsideron se zbatohen vetëm dispozitat e LKA dhe masat kohore që

janë përcaktuar në LSK, duke kontestuar kompetencën e Gjykatës Administrative që të vendos për masa kohore, duke theksuar se në nenin 3 të LKA, ku është konstatuar kompetenca për vendimmarrjen në kontest administrativ nuk janë theksuar masat e (për) kohshme, dhe se në çdo rast kompetenca e Gjykatës Administrative rezulton nga neni 31 të LSK.

Parashtruesja konsideron se mos qëndrueshmëria në zbatimin përbëhet në atë se gjykatat administrative absolutisht nuk e zbatojnë LSK gjatë vendimmarrjes për masë të (për) kohshme, ndërsa në anën tjetër gjykatat civile në veprimin gjerësisht e zbatojnë LSK dhe sjellin masa të (për) kohshme edhe para parashtrimit të padisë.

Sipas nenit 2 të Ligjit për konteste administrative (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 96 të datës 17.05.2019), Në kontestin administrativ sigurohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik dhe juridik kundër akteve dhe veprimeve të veçanta administrative të organeve publike në pajtim me këtë ligj. Neni 3 i Ligjit e përcakton kompetencën përkatësisht lëndën e kontestit administrativ.

Sipas nenit 29 (1) Gjykata mund të lëshojë masë të përkohshme me kërkesë të palës, nëse kjo nevojitet që t’i shmanget dëmit serioz dhe të pamënjanueshëm. (2) Gjykata vendos për masat kohore me aktvendim. (3) Kundër aktvendimit për masën kohore lejohet ankesë. (4) Padia, me kërkesën për lëshimin e masës kohore nuk e parandalon zbatimin e aktit kundër të cilit është parashtruar, përveç nëse me ligj nuk rregullohet ndryshe. (5) Me kërkesë të paditësit, gjykata do ta anulojë zbatimin e aktit të kontestuar deri në miratimin e vendimit të plotfuqishëm, nëse me zbatimin e aktit do t’i shkaktojë paditësit dëm që vështirë mund të kompensohet. Gjatë vendimmarrjes, gjykata doemos duhet në pajtim me parimin e proporcionalitetit, ta marrë parasysh interesin publik si dhe interesin e paditësit dhe personave të interesuar. (6) Paditësi për shkaqet e theksuara në paragrafin (5) të këtij neni mund të kërkojë edhe miratimin e masave kohore për rregullimin e përkohshëm të gjendjes në lidhje me marrëdhënien e kontestuar juridike, nëse dëshmohet probabiliteti për nevojën e tillë, veçanërisht në marrëdhëniet ekzistuese juridike. (7) Për miratimin e masës kohore nga paragrafi (6) të këtij neni gjykata vendos në këshill. (8) Gjykata vendos për lëndën për miratimin e masës kohore në afat prej shtatë ditësh nga pranimi i kërkesës me aktvendim që duhet të arsyetohet. Gjykata mund miratimin e masës kohore ta kushtëzojë me dhënien e garancisë për dëmin i cili me shqiptimin e tij do të mund të shkaktohet për palën e kundërt. (9) Kundër aktvendimit nga paragrafi (8) të këtij neni, pala mund në afat prej tri ditësh të parashtrë ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative. Gjykata e Lartë Administrative vendos për ankesën në afat jo më të gjatë se 15 ditë nga dita e pranimit të saj.

Ligji për sigurimin e kërkesave, neni 20 – 42 e rregullon zbatimin e masës kohore.

Sipas nenit 30 (1) Në rastin kur procedura kontestimore ose procedura tjetër gjyqësore nuk është mbajtur, për vendosje për propozimin për sigurim me masë të përkohshme dhe për zbatimin e masës së përkohshme, me kompetencë vendore është

gjykata e cila do të vendoste në procedurën kontestimore ose procedurën tjetër gjyqësore. (2) Nëse procedura është mbajtur me propozim për sigurim të masës së përkohshme dhe për zbatimin e asaj mase të përkohshme, me kompetencë vendore është gjykata para së cilës është mbajtur procedura.

Sipas nenit 31, masa e përkohshme mund të lejohet para dhe gjatë mbajtjes së procedurës gjyqësore ose administrative.

Ligji për sigurimin e kërkesave përcakton masa të përkohshme për sigurimin e kërkesës me para (neni 33) dhe masa të përkohshme për sigurimin e kërkesës pa para (neni 35).

Neni 34 të LSK i përfshin të gjitha llojet e masave të përkohshme për sigurimin e kërkesave me para.

(1) Për sigurimin e kërkesës me para mund të lejohet secila masë me të cilën arrihet qëllimi i sigurimit të tillë, e sidomos: 1) ndalimi i debitorit të disponojë me sende të luajtshme, si dhe ruajtja e atyre sendeve; 2) ndalimi i debitorit t'i tjetërsojë ose t'i ngarkojë patundshmëritë e tij ose të drejtat reale të cilat mbi patundshmërinë janë shënuar në dobi të tij, me shënimin e atij ndalimi në librin publik ose t'i japë me qira; 3) ndalimi i debitorit të shesë letra me vlerë dhe kontribute; 4) ndalimi i debitorit të debitorit t'i paguajë debitorit kërkesë ose t'i dorëzojë sende, si dhe ndalimi i debitorit të pranojë sende, të arkëtojë kërkesë dhe të disponojë me to; dhe 5) urdhëresë bartësit të qarkullimit me pagesë që debitorit ose personit të tretë, me urdhëresë të debitorit, të mos lejojë nga llogaritë e debitorit pagesën e shumës së parave për të cilën është lejuar masa e përkohshme. (2) Me masën e përkohshme nuk fitohet e drejta e pengut.

Neni 36 i përcakton llojet e masave të përkohshme për sigurimin e kërkesës pa para.

Për sigurimin e kërkesës pa para mund të lejohet secila masë me të cilën arrihet qëllimi i kërkesës së tillë, e sidomos: 1) ndalimi i tjetërsimit dhe ngarkesës së sendeve të luajtshme ndaj të cilave është drejtuar kërkesa, si dhe ruajtja e atyre sendeve; 2) ndalimi i tjetërsimit dhe ngarkesës së patundshmërisë ndaj së cilës është drejtuar kërkesa, me shënim të ndalimit në librin publik; 3) ndalimi i debitorit të ndërmarrë veprime të cilat mund t'i sjellin dëme kreditorit, si dhe ndalimi të bëhen ndryshime të sendeve ndaj të cilave është drejtuar kërkesa; 4) ndalimi i debitorit të debitorit që debitorit t'ia dorëzojë sendet ndaj të cilave është drejtuar kërkesa; dhe 5) pagesa e kompensimit të rrogës punëtorit gjatë kohës së kontestit për shkak të paligjshmërisë së vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nëse kjo është e domosdoshme për përkujdesjen e tij dhe përkujdesjen e personave për të cilët sipas ligjit është i detyruar të përkujdeset.

Nga përmbajtja e nenit 29 paragrafi (5) dhe (6) të Ligjit për procedurë kontestimore, rezultojnë dy lloje të masave kohore edhe atë, masë kohore për anulimin e zbatimit të aktit të kontestuar në vendimmarrjen e vendimit të plotfuqishëm dhe masa kohore për rregullimin e gjendjes në lidhje me marrëdhënien e kontestuar juridike.

Në nenin 29 paragrafi (10), (2), (5), (7), (8) të Ligjit, ligjvënësi e përdor nocionin “grykata”, përderisa në paragrafin 9 e thekson grykatën konkrete që vendos kundër aktvendimit të shkallës së parë respektivisht “aktvendimin e paragrafit 8”, e ajo është Grykata e Lartë Administrative, fakte që theksojnë konkluzion se masat kohore në procedurë administrative, që vepron sipas dispozitave të Ligjit për konteste administrative.

Sipas parimit të ligjshmërisë, grykata vendos në kontest administrativ në bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, duke mbajtur llogari për konsistencën e vendimeve të veta, përmes të cilës mundësohet siguria juridike dhe zbatimi i barabartë i ligjeve – neni 7 të LKA.

Sipas nenit 14 (Zbatimi përkatës i dispozitave nga rregullat tjera), (1) Për çështjet në procedurën që nuk janë rregulluar me këtë ligj, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore.

Nga përmbajtja e ligjeve në fjalë, rezulton se ato kanë dallim terminologjik sa i përket titullit të këtij instituti juridik. Ligji për konteste administrative këtë institut e njeh si masë të përkohshme, përderisa Ligji për sigurimin e kërkesave si masë kohore, fakte të cilat i vëren edhe parashtruesja e kërkesës. Në qoftë se analizohen sipas përmbajtjes (nga ana materiale), vërehet dallimi, por në një pjesë edhe përshtatja e llojeve të masave kohore respektivisht të përkohshme.

Në qoftë se analizohet përmbajtja e nenit 14 të Ligjit për konteste administrative rezulton qartë se zbatimi supsidiar i rregullave tjera vjen parasysh vetëm për çështjet në procedurën që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, në mënyrë eksplicite duke e vënë në dukje zbatimin e LPP, por jo edhe të ligjeve tjera.

Duke u nisur nga kjo dispozitë, situata e lëndës juridike e iniciuar nga parashtruesja e kërkesës është e pakontestueshme, sidomos për shkak të karakterit të procedurës administrative dhe faktin se masa kohore në këtë procedurë është rregulluar në Ligjin për konteste administrative, edhe krahas asaj që në Ligjin për sigurimin e kërkesave – neni 31 theksohet se masë e përkohshme mund të lejohet para dhe gjatë mbajtjes së procedurës gjyqësore apo administrative. Në këtë kontekst, aq më tepër duke marrë parasysh faktin se në këtë dispozitë ligjvënësi operon me nocionet procedurë gjyqësore dhe administrative, ndërsa procedura administrative nuk është procedurë gjyqësore.

Dilema e parashtruar nga ana e parashtrueses së Kërkesës, e motivuar nga vendimi konkret i Grykatës Administrative dhe Grykatës së Lartë Administrative, që ka të bëjë me dallimin në procedurën për parashtrimin e kërkesës së masës kohore respektivisht masës së përkohshme, dhe në lidhje me nevojën e ekzistimit të padisë ose jo, nuk paraqet mospërputhje gjatë veprimit të grykatave administrative dhe civile në

zbatimin e institutit masë e (për) kohshme, për shkak që ato janë dy procedura të ndryshme të rregulluara me ligje të ndryshme, sidomos për shkak faktit që në këtë rast neni 14 të LKA nuk lejon zbatimin supsidiar të një ligji tjetër, përveç LPP që në situatën konkrete nuk mund të gjejë zbatim, për arsye se kjo çështje është rregulluar me Ligjin për kontestet administrative.

Nga shkaqet e sipër theksuara Seanca e përgjithshme konstaton se nuk rezulton nevoja për miratimin e qëndrimit parimor.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 18.04.2022, sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019) dhe nenit 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 14/2022), duke vendosur mbi Kërkesën për qëndrim parimor (mendim), të parashtruar nga Sektori i pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional invalidor, doganë, koncesione dhe partneritet publik privat si dhe të drejtat lidhur me Gjykatën Administrative Shkup, nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Kërkesa për qëndrim parimor (mendim) 03.Su.nr.138/22 të datës 21.02.2022 të parashtruar nga Sektori i pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional invalidor, doganë, koncesione dhe partneritet publik privat si dhe të drejtat lidhur me Gjykatën Administrative Shkup, NUK APROVOHET.

## A r s y e t i m

Sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 18.04.2022 diskutoi mbi Kërkesën për qëndrim parimor (mendim), të parashtruar nga Sektori i pensioneve, të drejtat për sigurimin pensional invalidor, doganë, koncesione dhe partneritet publik privat si dhe të drejtat lidhur me Gjykatën Administrative Shkup, 03.Su.nr.138/22 të datës 21.02.2022, lidhur me çështjen për kompetencën e Gjykatës Administrative që të veprojë për kontestet kundër vendimeve me të cilat ndërpriten marrëveshjet e koncesioneve.

Në kërkesën është theksuar se parashtruesi - Sektori i theksuar në Gjykatën Administrative përballet me dy qëndrime të ndryshme që janë marrë nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Gjykatës së Lartë Administrative, lidhur me veprimin për padi kundër një akti me të cilin ndërpritet marrëveshja e koncesioneve e lidhur midis Qeverisë së RMV si koncedent dhe të një subjekti tjetër si koncesionar.

Parashtruesi, sqaron se sipas nenit 3 paragrafi (1) pika 8 të Ligjit për konteste administrative (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), Sektori ka marrë qëndrim se Gjykata Administrative është kompetente që të veprojë kundër akteve dhe veprimeve lidhur me koncesionet deri në lidhjen e marrëveshjeve administrative përkatësisht marrëveshjeve të koncesioneve, e jo edhe kur është në pyetje prishja e marrëveshjes së koncesionit, në

mënyrë që Gjykata Administrative është deklaruar si jo kompetente dhe lëndën me të gjitha shkresat e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore Civile kompetente. Qëndrimi i theksuar është konfirmuar nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative. Në bashkëngjitje janë dorëzuar edhe aktvendimi U6.nr.1053/2020 të datës 22.06.2020 të Gjykatës Administrative dhe aktvendimin UZH-2.nr.532/20202 të datës 08.07.2021 të Gjykatës së Lartë Administrative.

Për të njëjtën lëndë, duke vendosur për ndeshjen e kompetencave, të shkaktuar nga Gjykata Themelore Civile Shkup, në kuptim të nenit 21 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë kontestimore, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me aktvendim R.nr.81/2021 të datës 03.11.2021, e ka caktuar Gjykatën Administrative të veprojë si gjykatë kompetente reale mbi padinë për prishjen e vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ndërprerje të njëanshme të Marrëveshjes së koncesionit, objekt i kontestit.

Parashtruesi konstaton se për shkak të qëndrimeve të shprehura të Gjykatës së Lartë Administrative dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me çështjen e theksuar ka nevojë urgjente për miratimin e qëndrimit parimor për sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve dhe në zbatimin e drejtë të principit të sigurisë juridike nga ana e gjykatave.

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vepruar për kërkesën e theksuar, nxori Konkluzion me të cilin konsideron se nuk rezulton nevoja për miratimin e qëndrimit parimor (mendim), ngase nuk ka zbatim të pabarabartë të ligjit.

Në fakt, sipas nenit 21 paragrafi (1) të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 79/2005...124/2015), nëse gjyqi të cilit i është lëshuar lënda si gjyqi kompetent konsideron se është gjyqi që ia ka lëshuar lëndën ose ndonjë gjyq tjetër, lëndën do t'ia dorëzojë gjyqit që duhet ta zgjidh konfliktin e kompetencave, përveç nëse sheh se lënda i është lëshuar për shkak të ndonjë gabimi të qartë, ndërsa është dashur t'i lëshohet ndonjë gjyqi tjetër, në atë rast lëndën do t'ia lëshojë gjyqit tjetër dhe për këtë do ta njoftojë gjyqin i cili ia ka lëshuar lëndën. Sipas paragrafit (3) nga i njëjti nen, vendimi i gjyqit të lartë për jo kompetencën reale të gjyqit të shkallës së parë lidh secilin gjyq të cilit më vonë do t'i lëshohet lënda e njëjtë, nëse gjyqi i shkallës së lartë është kompetent për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës ndërmjet atyre gjyqeve.

Sipas nenit 22 nga i njëjti ligj, konfliktin e kompetencës ndërmjet gjyqeve e zgjidh drejtpërdrejtë gjyqi më i lartë i përbashkët.

Sipas nenit 23 paragrafi (3) nga i njëjti ligj, kundër aktvendimit me të cilin vendoset për konfliktin e kompetencës nuk lejohet ankesë.

Duke u nisur nga dispozitat e cituara, dhe si Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vendimin e miratuar të sipër theksuar, për konfliktin e shkaktuar

real të kompetencës ndërmjet Gjykatës Administrative dhe Gjykatës Themelore Civile Shkup, ka shprehur qëndrim lidhur me çështjen e kompetencës për veprimin e llojit të këtillë të lëndëve, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

Gjykata Supreme e  
Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme